



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës / Kancelarija Specialnog Tuzilastva Republike
Kosovo / Special Prosecution Office of the Republic of Kosovo

PPS nr.98/2017
Datë: 27.11.2023
PRISHTINË

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË
- Departamenti Special -

Në bazë të nenit 234 par. 2 dhe nenit 235 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), ushtroj këtë:

AKTAKUZË
për gjykim në mungesë

Kundër të pandehurit Millan Jovanoviq (Milan Jovanović), nga i ati Stojan, i lindur [REDACTED] në Ferizaj, ku edhe ka jetuar, tani me vendbanim të panjohur, me nacionalitet serb, ish polic në Stacionin policorë në Ferizaj, me numër të letërnjoftimit [REDACTED] i lëshuar nga Sekretariati i Punëve të Brendshme në Ferizaj.

S e p s e

I pandehuri Millan Jovanoviq, në kohën e luftës në Kosovë, si pjesëtarë i forcave policore të Serbisë, gjatë një sulmi të gjerë dhe sistematik nga forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serbe, kundër popullatës civile shqiptare në tërë territorin e Kosovës, duke ditur për ekzistimin e një sulmi të tillë, me përdorimin e dhunës dhe veprimeve të tjera çnjerëzore, në bashkëkryerje me persona të tjerë, deri tani të paidentifikuar, ka kryer dhunim seksual ndaj gruas së nacionalitetit shqiptarë.

-me çka i pandehuri në bashkëkryerje me persona të tjerë të uniformuar dhe të armatosur ka kryer vepër penale Krimet e Luftës kundër popullsisë civile nga neni 142 lidhur me nenin 22, të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, aktualisht e

inkriminuar si Krimet kundër njerëzimit nga neni 143 par.1 nënpar, 1.6; dhe 1.7; lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 237, par.3, nënpar 3.1, 3.2 dhe 3.3 të KPPRK-së, janë redaktuar të dhënat për të pandehurin.

Dispozitivi dhe arsyetimi i kësaj aktakuze janë redaktuar me qëllim të mbrojtjes së identitetit të viktimës, konform nenit 237, par.3, nënpar. 3.4 , dhe par.8 të KPPRK, si dhe në përputhje me Urdhrin e gjykatës për masë mbrojtëse PPPS.nr.33/2023 të datës 21.08.2023.

Redaktimi në këtë masë është i nevojshëm për arsye se nga përshkrimi i veprës penale në dispozitivin e aktakuzës, dhe nga përmbajtja e deklaratave të viktimës dhe dëshmitarëve, si dhe të dhënave të tjera në aktakuzë, mund të zbulohet identiteti i viktimës dhe anëtarëve të familjes së saj, gjë që mund t'iu shkaktoj rrezik të rëndë dhe pasoja të pariparueshme.

Drita Hajdari
Prokurore e Shtetit

